

UDHËZIM
Nr. 6, datë 9.5.2013

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 965, DATË 11.12.2007 “PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR TRANSFERIMIN E AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE NË NJËSITË E QEVERISJES VENDORE””

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 660, datë 12.9.2007 “Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve në njësitë e qeverisjes vendore”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 965, datë 11.12.2007 “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve në njësitë e qeverisjes vendore””, bëhen këto ndryshime:

1. Në bazën ligjore, fjalët, “...të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” zëvendësohen me fjalët “... të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar””.

2. Në pikën II. 7, pas fjalisë së dytë shtohet një fjali si vijon:

“Ky autorizim kërkohet vetëm për mbledhjet e para të ansambleve të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, ndërsa për mbledhjet e tjera procedohet sipas legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Florjon Mima